



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
QENDRA E PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE
DREJTORI

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, ____ . ____ . 2024

FTESË PËR NEGOCIATA

AGJENCIVE TË SPECIALIZUARA/ORGANEVE TË MEDIAS VIZIVE

Mbështetur në pikën 1/b të neni 7 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe në pikën 9 të VKM-së nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve të reklamave për transmetimin nga operatorët radiotelevizivë ose botim në mediane e shkruar dhe për kontratat me kohë transmetimi nga organet e Administratës shtetërore”, **Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka planifikuar të zhvillojë procedurën (me negociata), me objekt: “Realizim Spoti në kuadër të tre vjetorit të krijimit të QPKMR-së dhe bashkëpunimit me Caritasin Shqiptar”**

OBJEKTI

Përshkrimi i punës:

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, në muajin Mars të këtij viti ka tre vjetorin e krijimit të saj si edhe mbush plot tre vite bashkëpunim të frytshëm me organizatën Caritas Shqiptar.

Qëllimi i realizimit të këtij spoti është promovimi i punës së vazhdueshme të QPKMR si edhe bashkëpunimit të ngushtë me Caritasin Shqiptar lidhur me rastet e rehabilitimit të të miturve në konflikt me ligjin.

Nevoja për kryerjen e këtij shërbimi: Në bazë të Objektivit nr.4, Masa 4.3.3.4 “Promovimi i modeleve pozitive të fëmijëve në konflikt me ligjin të riintegruar”, të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026.

Fondi limit i përcaktuar: fondi limit i procedurës është në vlerën: **830,000 (tetëqind e tridhjetë mijë) Lekë pa TVSH**

Shpeshhtësia e shfaqjes së spotit: Videoja/Spoti do të publikohet në website e QPKMR-së, portale online, të ketë mbulim mediatik (1 herë) brenda 5 (pesë) ditëve nga lidhja e kontratës, website qeveritare, faqe të organizatave të ndryshme me të cilat QPKMR ka marrëveshje bashkëpunimi si edhe do të përdoret si prezantim i punës së QPKMR-së në aktivitetet që zhvillohen në shkollat e arsimit para universitar në Republikën e Shqipërisë si dhe në aktivitete të tjera që zhvillohen përgjatë gjithë vitit.

Afati përfundimtar për paraqitjen e ofertave nga media e shkruar/agjencia e specializuar **është më datë 14.02.2024, ora 10:00.**

Konfirmimet për vazhdimin e negociatave: Ofertat dhe dokumentacioni duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jo transparent, në një ditë të vetme, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm komisioni i vlerësimit të ofertave dhe jo përpara datës **14.02.2024, ora 10:00.**

Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura.

Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni konfirmimin pranë Autoritetit tonë kontraktor.

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve

Adresa: Rr.Federik Shiroka, Godina Nr.8, kati IV, Tiranë, Shqipëri

Adresa e Internetit: www.qpkmr.gov.al

Email: qpkmr@drejtesia.gov.al

Gjuha për hartimin e ofertave është: Shqip

Termet e referencës :

Qëllimi i kësaj

Qëllimi i realizimit të këtij spoti është promovimi i punës së vazhdueshme të QPKMR si edhe bashkëpunimit të ngushtë me Caritasin Shqiptar lidhur me rastet e rehabilitimit të të miturve në konflikt me ligjin.

1. Përshkrimi:

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka në fushën e veprimtarisë së saj parandalimin e krimeve të të miturve dhe të rinjve, kjo edhe nëpërmjet aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit që do të mirëpresë të miturit pas përfundimit të periudhës së dënimit apo lirimit me kusht.

Me përfshirjen e QPKMR-së në masat e strategjisë së re ndërsektoriale për të miturit 2022-2026 lind nevoja për përmbushjen e tyre. Shërbimi i kërkuar sa më lart është detyrim që lind nga objektivi Nr.4 masa 4.3.3.4 “Promovimi i modeleve pozitive të fëmijëve në konflikt me ligjin të riintegruar” të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026.

Prodhimi i spotit me këto specifikime:

1.1 Specifikimet teknike dhe produksioni

- Minutazhi i videos 10-15 minuta
- Video Full FHD 1920x1080
- Montimi profesional i videos
- Editimi profesional i videos ku të përfshihen rregullimi i ngjyrave, grafika, kualiteti i zërit dhe të tjera sipas nevojës
- Produksioni
- Xhirimi në skena të ndryshme, me kamera, dron por pa u kufizuar sipas nevojave
- Transmetimi në TV të paktën 30 sec
- Shpeshtesia 1 herë 10:00-12:00 paradite
- Materiali përfundimtar duhet të jetë i përshtatur edhe për TV dhe të zotërojë të gjitha të drejtat e rezervuara të përdorimit të pakufizuar.
- Spoti duhet të përmbajë sloganin kryesor, logon zyrtare të QPKMR-së dhe ëbsite-in zyrtar të institucionit, qpkmr.gov.al.
- Operatori Ekonomik duhet të sigurojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e Spotit.

1.2 Tematika, skenografia

- Skena të xhiruara me të miturit e rehabilituar
- Narrative e rrugëtimit të të miturve që nga mometi i futjes në Institutin e të Miturve Kavajë e deri tek dalja nga instituti dhe vazhdimësia e rutinës ditore pas lirimit.
- Intervista me të miturit e dalë nga Instituti i të Miturve në Kavajë (Intervistat do të zhvillohen në qytete të ndryshme të Shqipërisë) ose familjarët e tyre.
- Skena të xhiruara të rasteve të suksesit (të mitur që punojnë ose studiojnë)

- Intervista me qendrën Caritas e cila ka dhënë një kontribut të vecantë në rehabilitimin dhe punësimin e të miturve që kanë qenë në konflikt me ligjin.
- Intervista me aktorët e sistemit të drejtësisë për të mitur, të cilët ndihmojnë në realizimin e objektivave ku përfshihet riintegrimi dhe rehabilitimi pas daljes së të miturit nga IM Kavajë (punonjës të Qendres së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, dhe aktorë të tjerë zinxhirit ndërinstucional)

INFORMACION DHE KËRKESA SPECIFIKE NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Dokumentacioni ligjor që duhet paraqitur si kriter kualifikues:

1. Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona

të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë nuk është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik sa më sipër.

2. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike që ka operatorit ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.
3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, pranë njësisë së qeverisjes vendore ku operatorit ekonomik është i regjistruar.

1. **Kapaciteti teknik:**

1. Operatorit Ekonomik Ofertues duhet të ketë realizuar minimumi një eksperiencë të ngjashme në fushën e prodhimit të reklamave/spoteve etj.

Kjo do të vërtetohet me dokumentet e mëposhtme:

- Për kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen data, shuma dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen data, shuma dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, me të cilën merr përsipër se ka kapacitetet e nevojshme për të konceptuar dhe realizuar produktin.
 3. OE duhet të vërtetohet me paraqitjen e CV, listë pagesave të sigurimeve shoqërore të tre muajve të fundit.

- Formularin e Ofertës Ekonomike

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre të lëshuara jo më vonë se 3 (tre) muaj para datës së hapjes së procedurës. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Afati i realizimit të shërbimit do të jetë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor duke filluar nga nënshkrimi i kontratës dhe sipas specifikimeve teknike ne Ftesën për Negociata.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

Përzgjedhja e ofertave do të bëhet sipas pikës nr. 7 dhe 12, të VKM nr. 1195 datë 05.08.2008.

Kriteret e Vlerësimit

- dokumentacioni ligjor i paraqitur
- eksperiencia e mëparshme e operatorit ekonomik
- çmimi më i ulët, i ofruar nga organi i masmedias

Vlerësohet me 50 pikë dokumentacioni ligjor i paraqitur

Vlerësohet me 30 pikë eksperiencia e mëparshme e operatorit ekonomik

Vlerësohet me 20 pikë çmimi i ofruar nga organi i masmedias/agjencia e specializuar.

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë, pa TVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, Zyrës së Protokollit, para orës së përcaktuar. Përzgjedhja e ofertave do të bëhet sipas pikës nr. 7 dhe 12, të VKM nr. 1195, datë 05.08.2008. Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave me përfaqësuesit e tyre ligjorë ose me personat e autorizuar me autorizimin përkatës.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet përtej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Këtë ftesë për negociata mund ta gjeni dhe në faqen e internetit të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, në adresën: www.qpkmr.gov.al

Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negociim.